



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 8 qershor 2011

**Akademia solemne e Lëvizjes Evropiane me rastin e
festimit të Ditës së Evropës**

Fjalimi i:

Ambasadorit z. Peter SØRENSEN

Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian

Kam kënaqësinë të marr fjalën në këtë Akademi Solemne të organizuar nga Lëvizja Evropiane.

Çështjet e Evropës janë shumë të rëndësishme për t'i lënë vetëm në duart e politikanëve!

Në mënyrë që Bashkimi Evropian të jetë gjithnjë i suksesshëm, qytetarët e Evropës duhet të jenë të involvuar dhe të ndjehen si pjesë e këtij procesi shumë dinamik të zhvillimit dhe ndryshimeve. Reformat dhe ndryshimet që janë rrjedhojë e marrjes së statusit të vendit kandidat nuk janë vetëm ushtrime në letër por gjëra që kanë ndikim real në të gjitha aspektet e jetës së përditshme.

Ngrohtësisht përuroj Lëvizjen Evropiane për përpjekjet e vazhdueshme lidhur me promovimin e vlerave evropiane në vend. Së bashku me të gjitha organizatat tjera të shoqërisë civile, kjo lëvizje kontribuon në përfundimin e frymës së fuqishme që veç më ekziston këtu. Do të vazhdojmë të punojmë në partneritet me ju dhe me autoritetet, në mënyrë që të mbajmë Evropën në krye të agjendave tona.

Delegacioni i Bashkimit Evropian feston Ditën e Evropës në bashkëpunim të ngushtë me Lëvizjen Evropiane. Kam kënaqësinë që mund të punoj me ju në organizimin e debateve dhe evenimenteve të ndryshme që nxisin diskutimet lidhur me çështjet e BE-së.

Mirëpo, Europa është diçka më tepër se një diskutim serioz dhe ndryshime legjislative. Programi i Ditës së Evropës reflekton disa përmasa: evenimentet simbolike me Ditën e Flamurit të Evropës; durimin dhe mirëqenien; vrapimin e maratonës; eksplorimin e evenimenteve muzikore dhe kulturore në mbarë qytetin dhe përfshirjen e të rinjve.

Duke iu drejtuar të rinjve që morën pjesë në debatin ndër-universitar mbi barazinë gjinore, kam shpresa të mëdha për ju dhe për vendin tuaj. Nga ajo që Zëvendësi im dëgjoi, mund të the se do të votoja për ju! Ju jeni ardhmëria. Ju jeni vendim-marrësit e të ardhmes. Dua t'u uroj të gjithë atyre që do të marrin çmime sonte, për përpjekjet e tyre individuale në promovimin e vendit të tyre dhe aspiratave të vendit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Edhe unë bashkë me ju ndaj aspiratat e anëtarësimit të vendit tuaj në BE.

Ju keni konfirmuar besimin tonë se Maqedonia mund të organizojë zgjedhje "të mira" edhe pse mbeten akoma gjëra të cilat duhen përmirësuar. Gjithashtu, jam i bindur se mund të vazhdoni realizimin e reformave dhe ndryshimeve të nevojshme, të cilat priten nga një shtet kandidat. Tani është koha e duhur për të arritur progres real, për t'i trajtuar çështjet e vështira me të cilat përballet vendi; është koha e përshpejtimit të reformave dhe implementimit të të gjitha premtimeve të dhëna. Do të keni mbështetjen tonë gjatë gjithë këtij shtegtimi sfidues.